

Çfarë do të thotë AVdual?

AVdual do të thotë "Ausbildungsvorbereitung dual", që shqip përkthehet "Përgatitje për trajnim profesional të dyfishtë". Bëhet fjalë për një program trajnimi për të rinjtë, të cilët kanë njohuri bazë të gjuhës gjermane dhe dëshirojnë të përgatiten për një trajnim profesional. U drejtohet të rinjve nga mosha 15 vjeç e lart. Pjesëmarrësit në programin AVdual mund të kenë mbaruar ose jo shkollën e mesme.

Gjatë kësaj periudhe, veprimtaritë e përgjithshme mësimore (si gjermanishtja dhe matematika) ose trajnimi profesional (si përgatitja e një vakti ushqimor ose lyerja e një muri) alternohen me praktika pune. Shkolla i ndihmon të rinjtë në kërkimin e një kompanie të përshtatshme.

Zakonisht AVdual zgjat 1 vit. Megjithatë, ndonjëherë, kohëzgjatja mund të shkurtohet në rast se të rinjtë janë menjëherë gati të nisin një trajnim profesional, ose të zgjatet (për shembull, në 2 vjet) në rast se ende kanë nevojë për mbështetje. Gjithashtu është e mundur të merret një diplomë e shkollës së mesme. Objektivi i AVdual është integrimi i menjëhershëm në tregun e punës ose në një trajnim profesional.

Ku zhvillohen kurset AVdual?

Në Baden-Württemberg ato zhvillohen në shkollat profesionale. Vendet e zakonshme:

- Shkollat profesionale
- Shkollat tregtare
- Shkollat e ekonomisë shtëpiake

Si bëhet regjistrimi?

- duke u regjistruar drejtpërdrejtë nga një shkollë
- ose nga një qendër punësimi (Jobcenter) / apo këshillimi profesional

Të rinjtë që ende nuk flasin gjermanisht, duhet të ndjekin paraprakisht një kurs VABO, para se të regjistrohen në një kurs AVdual. Për të mësuar se çfarë do të thotë VABO, lexoni fletën tonë informuese "Was bedeutet die Abkürzung VABO?".

https://www.wegweiser-bw.de/fileadmin/user_upload/VABO_DE-1_ALB_end.pdf

